

VENDIM
Nr. 213, datë 13.4.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 546, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE SHITESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, TË ATASHEVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PERSONELIT CIVIL TË MINISTRISË SË MBROJTJES, QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-s, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS PRANË QENDRËS SECI, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PROKURORI I SISTEMIT TË PROKURORISË PËR KOHËN QË SHËRBEN SI PROKUROR NDËRLIDHËS PRANË EUROJUST NË HAGË, HOLANDË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; të nenit 53, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. Punonjësit e personelit diplomatik, të cilët shërbejnë në Misionin e Përherëshëm të Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në *New York*, për një periudhë dyvjeçare të anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit, 1 dhjetor 2021 deri në 15 janar 2024, përfitojnë një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për periudhën 1 dhjetor 2021 deri në 15 janar 2024, përballohen nga buxheti i planifikuar për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për secilin vit buxhetor.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 dhjetor 2021.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 9

MASA E SHPËRBLIMIT MUJOR PËR ÇDO POZICION TË PERSONELIT TË SHËRBIMIT DIPLOMATIK, NË MISIONIN E PËRHERSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PRANË OKB-SË, NË *NEW YORK*, PËR PERIUDHËN 1 DHJETOR 2021–15 JANAR 2024

	Pozicioni	Shpërblimi mujor në vlerë
1	Ambasador	1020 dollarë USD
2	Ministër Fuqplotë Ministër Këshilltar	780 dollarë USD
3	Këshilltar	690 dollarë USD
4	Sekretar i Parë	550 dollarë USD
5	Sekretar i Dytë	450 dollarë USD
6	Sekretar i Tretë	390 dollarë USD
7	Atashe	350 dollarë USD